



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
QENDRA E SHËRBIMEVE ARSIMORE
DREJTORIA E PROVIMEVE TË SHTETIT**

N J O F T I M

**PËR TESTIMIN E INFORMATIZUAR TË MATURANTËVE NË KUADËR TË
PRANIMIT NË PROGRAMIN MJEKËSI E PËRGJITHSHME NË UNIVERSITETIN
E MJEKËSISË, TIRANË, KATEGORIA E VEÇANTË**

Për të gjithë maturantët që do të marrin pjesë në testimin e informatizuar në kuadër të pranimit në programin e studimit “Mjekësi e Përgjithshme” në Universitetin e Mjekësisë, Tiranë, kategoria e veçantë, ju bëjmë me dije se testimi do të zhvillohet pranë Qendrës së Shërbimeve Arsimore (QSHA), me adresë: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Nr. 23, Tiranë (ish-ATSH), në datën **16.09.2025, ora 10:00**.

Ditën e zhvillimit të testimit të informatizuar, maturantët duhet të kenë parasysh:

- të jenë të pajisur me dokument identifikimi (kartë identiteti ose pasaportë);
- të paraqesin faturën origjinale të pagesës së tarifës së testimit për llogari të QSHA.
- të paraqiten së paku 30 minuta përpara fillimit të testimit;
- ndalohet mbajtja dhe përdorimi i celularëve apo mjeteve të tjera të komunikimit gjatë zhvillimit të testimit, pasi kjo vlerësohet si kriter mos kualifikimi;
- ndalohet komunikimi me kandidatët e tjerë gjatë zhvillimit të testimit deri në marrjen e deklaratës së rezultatit;
- ndalohet lëvizja përtej vendit të përcaktuar për zhvillimin e testimit;
- firmos deklaratën e rezultatit të marrë.

Faturën për arkëtim për kryerjen e pagesës mund ta shkarkoni në faqen zyrtare të QSHA www.qsha.gov.al, në linkun: <https://qsha.gov.al/wp-content/uploads/2025/02/Fature-e-arketimit-te-tarifese-per-kandidatet-qe-japin-provimet-e-tjera-te-digjitalizuara-prane-QSHA-se.pdf>

Orari i pjesëmarrjes në testim, i cili do të jetë i përcaktuar dhe nuk do të mund të ketë ndryshime.

Ju urojmë suksese!